

nga Rahoveci/Orahovac e bartte mallin nëpër Serbi. Ditën tjetër [20.02.1998], u nisën nga Kraleva për në Kosovë rreth orës 11:00. Përderisa po kalonin nëpër **Llaushë/Lauša**, rreth orës 15:30, një burrë i veshur në uniformë, me pushkë automatike dhe flamurin shqiptar doli në rrugë përpara tyre. Në çastin kur Miloradi dhe Zdravkoja e parakaluan, ai hapi zjarr ndaj tyre. Të shtënat vinin edhe nga kulmet e shtëpive të afërta. Miloradin e kanë plagosur në stomak, ndërsa Zdravkon në dorën e majtë dhe në kokë. Por, arritën të largoheshin dhe arritën deri te postblloku i parë policor, nga ky Miloradin e bartën në spitalin e Pejës/Peć. Ka dhënë shpirt po atë ditë. Familjarët e kanë varrosur më 22.02.1998 në varrezat e Gjakovës/Đakovica.

Burimet: deklarata Z.Đ, FDH-468; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 16, 904; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; *Dnevnik od 18. do 23. februara 1998*, Ilustrovana politika, 28.02.1998, FDH-36817; *Teroristi mučili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

Regjistrimet për personat që janë vrarë dhe kanë pësuar në **Qirez/Ćirez** më 28.02.1998 mund të shikohen në faqet 83, 85, 86 dhe 87.

Mustafë (Kadri) Sejdiu

(1952, shqiptar nga Prelloci/Prelovac, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtime, shtatë fëmijë)

Mustafa me bashkëshorten Vahiden dhe fëmijët jetonin në Prelloc/Prelovac, në **Mëhallën Sejdiu**. Në mëngjes, më 28.02.1998, pasi e përfunduan kafjallin, dëgjuan krismat nga drejtimi i Qirezit/Ćirez dhe Likoshanit/Likošane [të shikohen regjistrime]. Nuk kishin njohuri për ngjarjet atje dhe vazhduan me punë të veta të përditshme. Nga ora 11:30, mbi fshat fluturoi një helikopter ushtarak duke shtënë. Mustafën, i cili në ato çaste gjendej në oborr në afërsi të ahurit [Prelloc/Prelovac], e qëlluan në gjoks. Ka mbetur i vrarë në vend. Një ditë më vonë, më 1.03.1998, familjarët e kanë varrosur Mustafën në varrezat e fshatit.

Atje prehet edhe sot.

Burimet: deklarata V.S, FDH-14429; deklarata R.I, FDH-12044.

Bekim (Beqir) Deliu

(27.05.1976, shqiptar nga Skënderaj/Srbica, elektrikist, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Bekimi ka lindur në Obri të Epërme/Gornje Obrinje, por me familje jetonin në **Skënderaj/Srbica**. Në datën 28.02.1998, njësi i Bekimit ka marr pjesë në luftimet e Likoshanit/Likošane. Po atë ditë, ai u kthye në Skënderaj/Srbica. Ishte shumë i shqetësuar. Ditën tjetër në mëngjes [1.03.1998], Bekimi doli jashtë i veshur në rroba civile. Pas disa orësh, i ati Beqiri doli për ta kërkuar. Nga një mik i Bekimit në lagjen *Saraj*, ai mësoi se Bekimin e kishin plagosur në një fushë të kësaj lagjeje dhe se dy miqtë e tij e kishin bartur te mjeku në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze. Nuk ka kaluar shumë kohë nga shkuarja e Beqirit atje dhe Bekimi ka dhënë shpirt. E kishte një plagë të dukshme nga snajperi në anën e majtë të gjoksit. Të nesërmen, e kanë varrosur në varrezat e Obrisë së Epërme/Gornje Obrinje. Pas lufte, më 26.11.2000, trupi i Bekimit u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në këtë fshat.

Burimet: deklarata B.G, FDH-28136; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; fotografi, FDH-26250.

Shaban (Murat) Jashari

(2.04.1924, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, mësues, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Zahide (Shaban Geci) Jashari

(25.01.1924, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, gjashtë fëmijë)

Adem (Shaban) Jashari

(28.11.1955, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, teknik i makinerisë, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Adile (Bahtir Rama) Jashari

(10.03.1959, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, pesë fëmijë)